

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-006/14

Prishtinë

21 tetor 2015

Në çështjen juridike të:

D.S

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetari i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Rolandus Bruin, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012, të datës 14 dhjetor 2012 (lëndët e regjistruar në AKP me numrat 37501, 37502, 37503), pas shqyrtimit të mbajtur më 21 tetor 2015 jo unanimisht mori këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesat e D. S., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-006/2014, GSK-KPA-A-007/2014 dhe GSK-KPA-A-008/2014, janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-006/2014.
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e D. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012, të datës 14 dhjetor 2012, për sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA37501, KPA37502 dhe KPA37503.
3. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012, të datës 14 dhjetor 2012, për sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA37501, KPA37502 dhe KPA37503.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 3 gusht 2007, D. S. (në tekstin e mëtejme: paraqitësja e kërkesës), ka paraqitur tri kërkesa të ndara në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), të regjistruara me numrat KPA37501, KPA37502 dhe KPA37503, në emër të vëllait të saj të ndjerë, M. D., duke kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore.
2. Në këto kërkesa, pretendohet se pronat e kërkuara janë humbur për shkak të rrethanave të ndërlidhura me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, duke cekur 17 qershor 1999, si datë të humbjes.
3. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo ka dorëzuar në AKP, këto dokumente:
 - Certifikatën e vdekjes nr. 201-1129/2007-01 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në komunën e Backa Topolas, më 20 shkurt 2007, që konstatohet se M. D. ka vdekur më 19 tetor 2006.
 - Fletën poseduese nr. 540, zona kadastrale e Lipjanit të lëshuar më 25 korrik 2007, nga Instituti Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër dhe Pronë të Paluajtshme në

Lipjan, ku ngastra e kërkuar 834, ishte e regjistruar në emër të M. D., si pronar i vetëm.

- Fletën poseduese nr. 190, të lëshuar më 25 korrik 2007, nga Enti Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër të Pronës së Paluajtshme në Lipjan, ku ngastra e kërkuar 370, ishte e regjistruar në emër të M. D. si pronar i vetëm.
4. Sipas të dy fletave poseduese të Qendrës për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Lipjan/Lipljan, ngastrat kadastrale të kërkuara nga paraqitësja e kërkesës, që ndodhen në komunën e Lipjanit, janë të regjistruara në emrin e tij, si:

Numri i ankesës dhe lënda e AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-006/14 (KPA37501)	Fleta poseduese nr. 540, ngastra nr. 834, te vendi i quajtur “Livada”, tokë kultivuese, e klasës së 2-të, në sipërfaqe prej 00.67.30 ha
GSK-KPA-A- 007/14 (KPA37502)	Fleta poseduese nr. 190, ngastra nr. 370 te vendi i quajtur “Kod Groblja Njivće”, tokë kultivuese, e klasës së 4-të, në sipërfaqe prej 00.57.92 ha
GSK-KPA-A-008/14 (KPA37503)	Fleta poseduese nr.190, ngastra nr. 370, te vendi i quajtur ”Kod Groblja Dugać”, tokë kultivuese, e klasës së 4-të, në sipërfaqe prej 00.97.87 ha

5. Më 22 korrik 2010, AKP-ja bëri identifikimin e pronës për kërkesën nr. KPA35701, duke e publikuar në Gazetën për Njoftim nr. 5 dhe në Buletinin e zyrës për prona të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i janë lënë kryetarit të fshatit Suhadoll, i cili u pajtua t’ia dorëzojë palëve të interesuara. Të njëjtat publikime janë lënë edhe në Gjykatën Komunale, Zyrën Kadastrale, Komunën e Lipjanit, Zyrën Regjionale në Prishtinë dhe në zyrat qendrore të UNHCR-it, Ombudspersonit, AKK, KDR dhe në Zyrën e UNMIK-ut në Graçanicë.
- Identifikimi fizik i kërkesave KPA37502 dhe KPA37503 është kryer më 19 prill 2010, dhe pronat e kërkuara janë gjetur të jenë të uzurpuara nga një person i panjohur.
6. Asnjë palë nuk ka shprehur interesim (brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079), që të marrë pjesë në procedurë lidhur me pronën e cila është subjekt i kërkesës; prandaj kërkesat janë konsideruar si të pakontestueshme.
7. Sipas raportit të verifikimit, të datës 12 dhjetor 2007, pronat e kërkuara janë gjetur në emër të L.D. (bashkëshortja e M. D.). Ndryshimet në kadastër janë bërë në bazë të vendimit për trashëgiminë nr.VI-0-864/06/8, të datës 4 dhjetor 2006, i cili është siguruar *ex officio*, nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së.

8. Paraqitësja e kërkesë është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive dhe është kërkuar që ta sjellë autorizimin e lëshuar nga bashkëshortja e vëllait të saj. Paraqitësja e kërkesës ka thënë se ajo nuk mund ta sigurojë autorizimin e kërkuar pasi ajo nuk ka asnjë kontakt me bashkëshorten e vëllait e cila tashmë është pronare e pronës së kërkuar .
9. Më 14 dhjetor 2012, Komisioni me vendimin e vet KPCC/D/A/180/2012, i ka refuzuar kërkesat me arsyetimin se paraqitësja e kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë pronësinë apo ndonjë të drejtë pronësore ndaj pronave të kërkuara, menjëherë para ose gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
10. Vendimi i KKKPK-së i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës më 27 gusht 2013.
11. Paraqitësja e kërkesës (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur ankesë më 26 shtator 2013.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese e kundërshton vendimin e KKKPK-së, por ankesa e saj përveç numrit të kërkesave, nuk specifikon ndonjë arsye për ankesë. Në fakt, ankesa është në lidhje me një kërkesë tjetër të cilën e ka paraqitur më herët në AKP.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, dhe është e pranueshme. Kolegji i Apelit të AKP-së ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.

Bashkimi i ankesave

14. Në pajtim me nenin 13.4 të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendos për bashkimin e ankesave, kur një bashkim i tillë i kërkesave është vendosur nga Komisioni në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen e lejon Komisionin që të merr në konsideratë

bashkimin e kërkesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr vendime kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të dëshmime.

15. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Civile që janë të zbatueshme në procedura para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079, si dhe dispozitën e nenit 408.1 lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 të Procedurës Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse një gjë e tillë do të siguronte efikasitet të lëndës në gjykatë.
16. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm me të cilin është paraqitur ankesa në fjalë, faktet, bazat ligjore dhe çështjet e dëshmime janë saktësisht të njëjta në të tria rastet. Vetëm ngastrat kadastrale, çështja lëndore e të drejtës pronësore që pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat janë të bazuara në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe në dokumente të njëjta. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesa është i njëjti.
17. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-006/14, GSK-KPA-A-007/14, GSK-KPA-A-008/14, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-006/14.

Meritat e ankesës

18. Gjykata Supreme e Kosovës e ka shqyrtuar vendimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa gjeti këtë:
19. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se kërkesat janë paraqitur nga D. S., në cilësinë e anëtarit të familjes së ngushtë të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, respektivisht vëllait të saj të ndjerë, M. D.
20. Sidoqoftë, pala ankuese nuk ka mundur ta dëshmojë se vëllai i saj ishte bartësi i së drejtës pronësore.
21. Sipas Certifikatës për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme të Zyrës Kadastrale Komunale të Lipjanit, të datës 12 dhjetor 2007, L. D. (bashkëshortja e M. D.) është e regjistruar si pronare e pronave të kërkuara.
22. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka kërkuar nga pala ankuese që të paraqet një autorizim të vlefshëm për ta përfaqësuar L. D. në AKP, mirëpo ajo ka deklaruar se nuk është e mundur të sigurohet autorizimi nga L. D., për shkak të mungesës së marrëdhënieve familjare.

23. Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së nuk ka mundur të sigurojë *ex officio*, ndonjë provë për të mbështetur kërkesën e D.. Në bazë të kësaj, KKPK-ja ka gjetur se D. D. nuk ka vërtetuar ndonjë të drejtë pronësore ndaj pronës kontestuese.
24. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, bazuar në procedurë të hollësishme dhe të saktë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e konsideron ankesën si të pabazuar.
25. Nga faktet e paraqitura, në pajtim me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

26. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it